



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KRUIË  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Krujë, më \_\_\_\_\_ . 2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ . 2023

”MIRATIMIN NË PARIM TE DHËNIES NË PËRDORIM ME ANË TË KONKURIMIT ME AFAT 10- VJECAR TË SIPËRFAQES PREJ 11.614 HA SE LLOJIT KULLOTË NE FSHATIN DËRVEN ZK 1475 ADMINISTRIM TË BASHKISË, PËR VENDOSJE STACIONESH, BAZAMENTESH PER PANELE FOTOVOLTAIKE ME QËLLIM PRODIIMIN E ENERGJISË”.

Bazuar ne dispozitat ligjore të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit 8480 datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale te administratës shtetërore dhe enteve publike" Ligjit nr.57/2020 dt.26.05.2020 "Për Pyjet"; Vendimit te Këshillit të Ministave nr.433, DATE 8.06.2016 "Për transferimin në pronësi te bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...", i ndryshuar me VKM nr. 684, dt.2.9.2020; Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 559 dt.29.07.2022 "Për Përcaktimin e Cmimeve dhe tarifave për dhënien në Shfrytëzim/Përdorim të fondit pyjor kornbëtar,për veprimtari ekonomike,sidhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore";Udhëzimit të Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit Nr.1, dt.9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit te kërkesave per dhënie në perdorim të fondit pyjor,sipas Relacionit dhe dokumentacionin perkatës per dhënje ne perdorim te siperfaqes fond pyjor me kategori përdoñmi të Ilojit kullotë Kryetari i Ba.shkisë

VENDOSI :

- 1 . Miratimin në parim të dhenjes në përdorim me anë të konkurimit me afat 10- vjeçar te sipërfaqes prej 11.614 ha së Ilojit kullotë në fshatin Dërven zk 1475 administrim te bashkisë,per vendosje stacionesh, bazamentesh per panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.
- 2, Vlera vjetore dysHEME e konkurimit për dhënjen në përdorim percaktohet sipas studimit tekniko ekonomik dhe VKM nr. 559 dt.29.07.2022,
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi,Sektori pyjeve

4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (Sipas përcaktimeve të pikës 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" ),i ndryshuar.

Mahmutaj  
n Malja  
a Çela



Përkiekjësi S. Pyjeve :  
Mahmuta•  
Specialist Shkelqim Malja  
Juriste Marsilda ela

Fehmi



Dr. juridike: Anila Haxhi



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA KRUIË  
SEKTORI PYJEVE DI-IE KULLOTAVE

Nr. 8038 Prot

Krujë më 25.09.2023

## RELACION

"MIRATIMIN NË PARIM TE DHËNIES NË PËRDORIM ME ANË TË KONKURIMIT ME AFAT 10- VJECAR TË SIPËRFAQES PREJ 11.614 HA SE LLOJIT KULLOTË NE FSHATIN DËRVEN ZK 1475 ADMINISTRIM TË BASHKISË, PËR VENDOSJE STACIONESH, BAZAMENTESH PER PANELE FOTOVOLTAIKE ME QËLLIM PRODIIMIN E ENERGJISË".

Të nderuar Keshilltar!

Struktura e Sherbimit Pyjor prane Bashkise Kruje, duke u bazuar ne prioritetet e saj per zhvillimin ekonomik si dhe ne baze te legjislacionit ne fuqi per sipërfaqet pyjore në të Cilat mund të ushtrohet veprimtari ekonomike ne fondin pyjor kombëtar, e vlerëson veprimtarine e mësipërme ne perputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore ne fuqi, parimet per zhvillimin e qëndrueshem silvikulturor dhe biologjik ekosistemit, si dhe mireadministrimin e tokës publike. Energjia . elektrike eshte nje nevojë themelore per njeriun, ekonomine dhe shtetin. Aktualisht prodhimi i energjiise elektrike eshte bazuar tek burimet hidrike te cilat jane ne varesi te resbjeve si dhe nga lendet djegese fosile si nafta, qymyri, gazi. Keto lende fosile janë shtershme dhe djegia e tyre Sjell efekte te demshme per mjedisin. Për shkak t? ketyre kufizimeve dhe me rritjen e vazhdueshme te kërkesës per energji elektrike alternative e vetme ngelet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë. Burime te rinovueshme te energjiise jane te shumta, si shfrytëzimi i energjisë nga Dielli i cili ne nje orë rrezaton energji te mjaftueshme, per te mbuluar konsumin e energjisë të përdorur nga njerezit ne nje vit dhe vendi ynë paraqet një pozitë mjaft të favorshme Për këtë industri duke marrë ne konsideratë ditet e shumta me diell giate nje viti. Tashme me teknologjitë qe disponojmë është zgjidhje e zgiuar dhe duhur të prodhojme energji elektrike falas nga natyra pa dëmtuar mjedisin dhe pa ndotur ajrin.

### ➤ Perfitimi Ekonomiko-Sociale:

- Impianti fotovoltaik siguron energji të gjelbert.
- Implementimi i impianteve fotovoltaik është i pershtatshëm Për tu integruar me rrjetin e shpërndarjes.
  - Shpenzimet operative dhe mirëmbajtja konsiderohen te papërfillshme.
- Qendrojnë ne giendje Pune ne periudha te gjata dhe pa mirëmbajtje teknike.
- Energjia e Fotovoltaik-eve është fleksibel dhe intervali i energjiise Së prodhuar prej tyre varion nga disa mikroëat ne megaëatt.
- Impianti nuk prodhon zhurma, per kete arsyeje eshte zgiidhja ideale per zonat urbane dhe per banesat.

- Strukturat mbajtese dhe te montimit kane impakt mjedisor "zero" dhe nuk tjetersojn giendjen fizike te terrenit.
- Jane statike, nuk kane paisje qe le.izin, per rrjedhoje ato kane shume pak ckycje te paplanifikuara dhe kane nevojte per supervizim.

• Rritja e sigurise se furnizimit me energji elektrike dhe diversifikimi i burimeve te energiise .

Struktura jonë e orientuar ne politikat e Qeverisë se Shqiperisë për mbrojtjen e tokës, me synim rritjen e të ardhurave per bLshkinë te cilat përkthehen ne investime në fondin pyjor, propozon dhënien në përdorim të tokës pyjore per zhvillimin e vepritarive: Per vendosje slacionesh, bazamente per panelefotovoliaike me qellim prodhimin e energiisë. Veprimtaria e mesipërme do te ketc një ndikim pozitiv për te ardhmen per gienerimin e të ardhurave per komunitetin që ndikohet, sigurimin e energiisë se gielbër, etj ne baze te akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, pika 'e' • Ligji nr. 57/2020, cit. 30.4.2020 "Per pyjet".
- Ligji nr. 8318, dt. 1.4.1998 "Per dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore te livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar.
- Vendimit te Këshillit te Ministave nr. 433, date 8.06.2016 Per transferimin ne pronësi te bashkive te pyjeve dhe të kullotave publike. i ndryshuar me VKM nr. 684, dt.2.9.2020.
- Vendimit te Këshillit të Ministave nr. 559 dt.29.07.2022 "per percaktimin e Cmimeve dhe tarifave per dhenien në Shfrytëzim/Perdorim te fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".
- Udhëzimit të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit Nr.1, dt.9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit te kërkesave per dhënie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik".
- Urdhërit nr 364 date 26.06.2023 'oer hartimin e raportit teknik per dhenien ne perdorim te siperfaqeve te fondit pyjor dhe kullor"Per ndertim teleferik pasagieresh ose linjë të tensionit,aerogeneratore dhe fotovoltaike"
- Raportit mbi studimin tekniko-ekonomik per dhenie ne perdorim fondi pyjor dhe kullor te sieprfaqeve te pronesi publike re Bashkise Kruje per fotovoltaike nga subjekti A.F.G Energji shpk, te hartuar nga Grupi i punes dhe i miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Në propozimin per dhënien e fondit pyjor në përdorim,me ane te konkurimit është mbajtur parasysh:

Veprimtaria ekonomike për dhënien e fondit pyjor në përdorim, per vendosje stacionesh, bazamente per panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energiisë nuk demtojnë ekosistemin por ndikojnë ne rritjen e zhvillimit ekonomik te vendit dhe ne ate zonë nuk janë parashikuar investime apo projekte afatgiata sipasplanit vendor te DPKZHT.

Referuar VKM nr.433 dt.8.6.2016, i ndryshuar me VKM nr. 684 dt.2.9.2020, Inventarizimit te Pyjeve dhe Kullotave,regjistrit kadastral, rezulton se sipërfaqja e propozuar është në administrim në fondin pyor/kullor publik të Bashkisë sipas hartave me nomenklaturë K-34-88(120-A);K-34-88(120-C).

Keto sipërfaqe pyjore nuk bën pjesë ne rrjetin e Zonave të Mbrojtura.

Përshkrim i shkurtër i vendndodhjes, karakteristikave stacionale dhe rivlerësime.

Pasuritë e identifikuar si me te përshtatshme per dhënien ne përdorim janë si më poshtë •

r i pasurise	na Kadastrale	Fshati/Nj.A	ipi i ngastrës	Sipërfaqia ha
199	1475	Dërven, N' .A Thumanë	Ku110Lë	3.167
200	1475	Dërven, Nj.A Thumanë	Kullote	0.7584
202/5	1475	Dërven, Nj .A Thumanë	Kullotë	3.809
203	1475	Dërven, N' .A Thumanë	Kullotë	0.385
205/7	1475	Dërven, Nj.A Thumanë	Kullotë	2.6096
227	1475	Dërven, N' .A Thumane	Kullotë	0,885
Totali i sipërfaqes				11.614 ha

Këto pasuri te transfeuara ne pronësi te bashkisë kruje sipas VKM nr.433 dt.8.6.2016, i ndryshuar me VKM nr. 684 dt.2.9.2020 ndodhen në fshatin Dërven,Nj .A Thumanë, në pjesën jugore te rezervuarit te burizanes ne veri lindje te fshatit kodër Dërven ne vendin e quajtur kullota e Dërvenit.

Këto sipërfaqe jane kryesisht te eroduara, zona pa pyje dhe toka me bimësi pyjore të rrallë. NC një pjesë të Sâi ka shkurre ne giendje te dobët vegetative me kurorë dendësi nën janë ne zona të pa zhvilluara nga ana sociale dhe rreth 400 metra mbi nivelin e detit. Me klime mesdhetare, me lagështirë të Iartë dhe jo e përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqesore.

Është toke e cekët ne mesatarisht të thellë që shkon nga 30 deri në 60 cm, pothuaj c freskët, me reaksion neutral dhe teksturë argiilore.

Legusha mungon. Gurët në sipërfaqe, në rreth 25% të saj.

Erozioni është mesatar.

Bimësia barishtore (leguminoze).

Bimet me vlere mjeksore, eterovajore dhe industriale natyrore, mungojnë.

Këto ngastra pjesë e ekonomisë pyjore "Terkuzë — Drojë" duke shikuar që plotesojnë kushtet e favorshme klimetarike dhe ekspozimin e përshtatshëm ndaj diellit propozojme që te jepen në perdorim me një siperfaqe totale prej 11.614 ha "Për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë".

Ne funksion te siperfaqes që merret ne perclorim sipas VKM Nr.559 dt.29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhënjen në shfrytëzim/ perdorim te fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore si dhe mënyrën e progedurën e mbledhjes se tyre" i ndryshuar me Vendimin nr.267 dt.27.04.2023 shtojca Ipika 8 "Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë te tensionit,aerogjeneratorë dhe fotovoltaike:

Përdorimi territorit	Tarifa sipas kohezgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
	1 vit	2-5 v•et	6-10 v•et

	P II trun ishte	240000	230000	210000
2	P II cun ishte	192000	184000	176000
3	P II shkurre	192000	184000	76000
4	Kullota	192000	184000	176000
5	Tokë me bimësi or,d err,	156000	150000	1 43000
6	Tokë me bimësi <u>pyior dierr</u> in r	156000	150000	143000

V

lera totale e pagesës në vit është 1760001ekë /ha/vit x 11.614 ha — —2044064 (dymilione dyzete katërmijë e gjashtedhjetë e katër lekë) lekë /vit.

Përsa më sipër :

Kërkojmë nga ana Juaj:

"Miratimin në parim të dhënjes në përdorim me anë të konkurimit me afat 10- vjeçar të sipërfaqes prej 11.614 ha së Ilojit kullotë në fshatin dërven zk 1475 administrim të bashkisë,për vendosje stacionesh, bazamentesh për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë"

Bashkëlidhur këtij relacioni keni materialin plotësues, i cili përmban:

Sipërfaqen pyjore publike, të shprehur në (ha), në shkallën 1:25 000, koordinata (gjatësi dhe gjërësi gjeografike, metrike) sipas sistemit 'KRGJSH'.

Treguesit identifikues te ngastrës, bazuar në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor dhe kullosor , identifikimin sipas listës së pronave, ekonomia, ngastra, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, treguesit kadastralë, etj.

Treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrale të pyjeve dhe kullotave bazuar në vlerën dysheme të Përdorim per ha/vit, të percaktuar me VKM - në Vendimit të Keshillit të Ministave nr. 559 dt.29.07.2022 "Për Përcaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhënien ne Shfrytëzim/Përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike ,si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" Gjithashtu gjeni studimin e detajuar, raportin teknik të dhëna teknike per ngastrën, fragmente të hartave pyjore dhe ortofoto.

Përgjeksi S. Pyjeve : Fehmi  
Mahmutaj  
Specialist Shk Iqim Malja ;Saviola V

Juriste

Marsilda Çela

utaj  
a Vogli



Adresa: Qender Kruje , Tel./ftxx 00355 511 2 2170 E-mail info@kruja .gov.al